



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, gjatë konferencës për ecurinë e çështjes më 19 nëntor, Trupi Gjykses diskutoi me palët afatet dhe hapat e ardhshëm për gjykimin. Ndër të tjera, Trupi Gjykses bëri të ditur se deri më 1 dhjetor do të vendosë lidhur me aspekte të provave për të cilat ende nuk ka dhënë vendim deri më tani.

Trupi Gjykses gjithashtu njoftoi palët se nuk parashikon të thërrasë dëshmitarë dhe se synon të mbyllë procedurën e paraqitjes së provave në këtë çështje më 4 dhjetor ose rreth asaj date. Trupi Gjykses ka ndër mend ta bëjë këtë me vendim publik, dhe jo në seancë të hapur.

Gjatë seancës, Trupi Gjykses dha edhe dy urdhra gojorë. Në urdhrin e parë, Trupi Gjykses, me kërkesë të Prokurorisë, pranoi si prova dy transkripte të seancave të mbajtura në Kongresin amerikan. Trupi Gjykses sqaroi se seancat në fjalë nuk ishin të llojit juridik dhe, për këtë arsye, nuk është e nevojshme që transkriptet të trajtohen sipas rregullave të Rregullores mbi deklaratat me shkrim të dëshmitarëve. Gjithashtu, Trupi Gjykses pranoi prova materiale të paraqitura nga Prokuroria, duke vënë në dukje se për to nuk pati kundërshtime nga pala tjetër apo Mbrojtja e Viktimave.

Më 18 nëntor, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Trupi Gjykses konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që të akuzuarit të pengojnë ecurinë e procesit dhe të kryejnë vepra penale të tjera. Trupi Gjykses kujtoi atmosferën e vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë dhe theksoi se lirimi i një të akuzuari në dijeni të informacionit të ndjeshëm në lidhje me dëshmitarët nuk do të ndihmonte në mbrojtjen efikase të tyre.

Trupi Gjykses rikujtoi se rreziku i ndërhyrjes që synohet të parandalohet me paraburgimin përfshin edhe tentimin për të marrë hak ndaj dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi në proces, ose për t'i nxitur ata të tërheqin dëshminë, si dhe tentimin për ndërhyrje ndaj dëshmitarëve në procese paralele. Sipas mendimit të Trupit Gjykses, vetëm masat në fuqi në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ofrojnë mjedis të kontrolluar mjaftueshëm, ku një shkelje e mundshme e konfidencialitetit mund të parandalohet ose të identifikohet më lehtë.

Seancat në këtë çështje gjyqësore janë shtyrë deri në një njoftim tjetër.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Isni Kilajt, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit, në lidhje me akuza për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, më 11 nëntor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren e Dhomave të Specializuara se çështja do të jetë gati për t'iu kaluar një trupi gjykses.

1





Më 12 nëntor, Kryetarja e Dhomave të Specializuara, Ekaterina Trendafilova, caktoi gjykatësin Kristofer Gosnell si Gjykatës të Vetëm i ngarkuar me gjykimin e asaj çështjeje. Kryetarja theksoi se sipas nenit 25 të Ligjit, akuzat kundër të gjithë të akuzuarve në këtë çështje nuk cilësohen si krime të rënda, sikurse përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, dhe se, për këtë arsye, trupi gjykues mund të përbëhet prej vetëm një gjykatësi. Po më 12 nëntor, Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri kalimin zyrtar të dosjes së çështjes.

Më 17 nëntor, Gjykatësi Gosnell caktoi datën e konferencës përgatitore për gjykim për më 28 nëntor, në orën 09:30 paradite.

Ai kërkoi që Prokuroria dhe Zyra Administrative të dorëzojnë parashtrime me shkrim deri më 20 nëntor, ndërsa Mbrojtja deri më 24 nëntor. Në këto parashtrime duhet të trajtohen, ndër të tjera, statusi i hetimeve të palëve, statusi i nxjerrjes së provave dhe nëse palët kanë ndër mend të kërkojnë konstatim gjyqësor të fakteve të shqyrtuara në procese të tjera, qoftë bashkërisht apo më vete. Ai kërkoi gjithashtu informacion nëse Prokuroria është e gatshme të bëjë deklaratën hyrëse javën e 15 dhjetorit dhe nëse dëshmitari i parë do të jetë gati të japë dëshmi po atë javë.

